



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 116, Datë 21.05.2018

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MAJ
2018**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87 pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me bendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017; nenit 15 të “Rregullores për Organizimi, Funkionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.05.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Maj 2018”,

Konstatoi se :

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 8247 Prot., datë 04.05.2018 (Protokolluar në ERE me 171/5 datë 10.05.2018), dërgoi në ERE aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për muajin Maj 2018.
- OSHEE sh.a. ka paraqitur në këtë aplikim/informacion mbi llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në 35 kV të cilët ndodhen në kushtet e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Maj 2018, në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.
- Të dhënat e paraqitura nga OSHEE sh.a. në këtë aplikim u krahasuan me raportimet e OSHEE sh.a. mbi blerjen e energjisë në treg të parregulluar për muajin Maj 2018 të dërguar në ERE paraprakisht këtij aplikimi me shkresën nr. 7666/12 Prot., datë 26.04.2018 (Protokolluar në ERE me Nr. 194/3, datë 10.05.2018) “Informacion mbi realizimin e procedurës së blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar për sistemin e shpërndarjes për periudhën 01.05.2018 -31.05.2018”

- Çmimi maksimal i blerjes së energjisë në treg të parregulluar për muajin Maj 2018 rezulton 33.75 Euro/MWh.
- Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në ditën kur është mbyllur procedura e blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar për sistemin e shpërndarjes për muajin Maj 2018 rezulton 129.06 Lek/Euro.
- Kosto e furnizimit me energji elektrike janë llogaritur konform nenit 6 dhe nenit 7 të Metodologjisë përkatëse dhe rezultojnë 0.44 lek/kWh për muajin Maj 2018.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratur me Vendimin Nr. 210, Datë 28.12.2017 *“Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2018”* është 0.75 Lek/kWh.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratur me Vendimin Nr. 211, Datë 28.12.2017 *“Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”* është 1.5 Lekë/kWh.
- Shoqëria “OSHEE” sh.a. ka aplikuar në ERE për një çmim prej 7.04 Lekë/kWh për furnizimin me energji elektrike nga FMF për muajin Maj 2018.
- ERE nga të dhënat e disponuara konstaton se për muajin janar konstatohet një diferencë pozitive ndërmjet energjisë së blerë dhe asaj të shitur për klientët FMF, nisur edhe nga fakti që metodologjia përkatëse nuk lejon korigjimin e çmimeve të përcaktuara. Diferenca e energjisë sa më sipër, **nuk është e qartë nëse kalon apo jo** për aktivitetin e shpërndarjes dhe atë të furnizuesit të shërbimit universal (FSHU).
- Për muajt shkurt dhe mars, diferencë negative ndërmjet energjisë së blerë dhe asaj të shitur për klientët FMF, **nuk është e qartë nëse** mbulohet **apo jo** nga blerjet e energjisë për klientët e furnizuar nga furnizuesi i shërbimit universal ose nga energjia e marrë nga prodhuesit me përparësi.
- Shoqëria “OSHEE” sh.a. për muajin Maj 2018, nuk ka paraqitur informacion mbi koston e disbalancave që shkaktohen nga klientët që furnizohen nga FMF, dhe nuk ka deklaruar që i ka faturuar ato për këtë kosto, ashtu siç kemi vërejtur dhe për periudhën Janar – Prill 2018.
- Nga analiza e të dhënave të disponueshme, konstatohet që diferencë midis energjisë së konsumuar nga klientët e FMF e furnizuar nga OSHEE dhe e planifikuar prej saj për FMF, çon në devijime dhe disbalanca për shoqërinë për energjinë e planifikuar dhe nominuar për furnizimin e klientëve në cilësinë e FMF.
- Devijimet e energjisë elektrike merren nga sistemi me anë të një mekanizmi, i cili ka trajtim dhe efekt të ndryshëm nga sigurimi i energjisë në cilësinë e FMF.

- Mos llogaritja dhe mos alokimi i shpenzimeve administrative të këtij aktiviteti, në lidhje me përcaktimin e çmimit për klientët FMF, krijon rrezikun e mbartjes së kostove të furnizimit të klientëve të FMF të kostot e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga FSHU.
- Çmimi referues për klientet e FSHU në nivelin përkatës të tensionit, sipas parashikimeve të vendimit të bordit të Komisionerëve të ERE nr.148, Datë 26.12.2014, i ndryshuar, përfaqëson kostot e shërbimit për klientët e lidhur në nivelin përkatës të tensionit, dhe duhet të përfaqësojë një çmim dysheme për përcaktimin e çmimit të klientëve të FMF.
- Përcaktimi i çmimit më të ulët se 9.5 lek/kWh për klientët e FMF nuk jep sinjale nxitëse për daljen e tyre në treg të parregulluar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.5 (nëntë pikë pesë) Lekë/kWh për muajin Maj 2018.
2. Drejtoria e Juridike dhe mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

PETRIT AHMETI